



---

**PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL**

**2025 - 2027**

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Prishtinë, Janar 2025

## Përbajtja

I.	DEKLARATA E INTEGRITETIT.....	3
II.	HYRJE .....	4
III.	PLANI PËR INTEGRITET .....	5
IV.	SFONDI.....	6
V.	PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT.....	7
5.1.	UDHËHEQJA .....	7
5.2.	PËRFSHIRJA E PERSONELIT.....	7
5.3.	QASJA SISTEMORE.....	7
VI.	OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT.....	9
6.1.	OBJEKTIVA STRATEGJIKE I.....	9
6.2.	OBJEKTIVAT SPECIFIKE JANË: .....	9
VII.	PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT .....	11
7.1.	FAZAT E ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT .....	11
7.2.	METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	12
7.3.	MATRICA VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	12
7.4.	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIKUT.....	13
VIII.	MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI .....	14
IX.	FUSHAT E RREZIKUT .....	16
9.1.	FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT .....	16
9.2.	FUSHAT SPECIFIKE TË RREZIKUT .....	16
	MATRICA E PLANIT I INTEGRITETIT MINISTRIA E SHËNDETËSISË .....	17

## **I. Deklarata e Integritetit**

Plani i Integritetit i Ministrisë së Shëndetësisë ka për qëllim të kontribuoni në zhvillimin dhe modernizimin e administratës publike, duke mbështetur politikat shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për të gjithë qytetarët.

Përmes këtij plani, Ministria e Shëndetësisë do të promovojë transparencën dhe llogaridhënien, duke siguruar përbushjen e rolit të saj në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo do të realizohet nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktivitetave parandaluese dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të kualitetit në kujdesin shëndetësor.

Ky plan është hartuar gjithashtu për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, veçanërisht nenit 25, i cili përcakton rolin kyç të administratës shtetërore në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit, duke promovuar integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjësinë për të gjithë zyrtarët publikë.

Ministria e Shëndetësisë synon të promovojë profesionalizmin, efikasitetin dhe një kulturë organizative të fokusuar në llogaridhënie dhe transparencë në raport me qytetarët, duke siguruar që integriteti dhe etika të jenë shtyllat kryesore të menaxhimit të saj.

Përmes këtij plani, Ministria e Shëndetësisë do të investojë në zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe trajnimin e stafit, për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj sfidave që lidhen me integritetin dhe për të menaxhuar rreziqet e mundshme.

Planifikimi dhe zbatimi i standardeve, parimeve dhe objektivave të parandalimit të korruptionit, si dhe të sjelljeve të tjera të paligjshme dhe joprofesionale, do të jetë pjesë e procesit të integruar. Identifikimi i reziqeve, implementimi i masave përkatëse dhe forcimi i kulturës së parandalimit të korruptionit do të kontribuoni në përmirësimin e punës së administratës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në shërbimet që ofrohen.

Duke u angazhuar në mënyrë të qëndrueshme për menaxhimin e rrezikut të integritetit, Ministria do të vazhdojë të zhvillojë dhe zbatojë masat e planifikuara, si dhe të krijojë një kulturë të integruar të menaxhimit të integritetit në organizatën e saj. Të gjithë zyrtarët janë të angazhuar për të parandaluar dhe zbuluar korruptionin dhe shkeljet e tjera të integritetit në kohë.

Ministria e Shëndetësisë është e përkushtuar të përfaqësojë interesat e qytetarëve, duke mbajtur një angazhim të palëkundur për etikën dhe standarde profesionale, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Ky Plan i Integritetit do të kontribuoni në luftën kundër korruptionit dhe në krijimin e një kulture organizative të bazuar në respektimin e kodit etik. Kjo do të rrisë besimin e qytetarëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe do të sigurojë një sistem të menaxhimit të integritetit gjithnjë e më të fortë dhe efikas.

## **II. Hyrje**

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe obligimet që dalin nga Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, konkretisht nen 25, i cili kërkon që të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit përiudhën 2025-2027.

Ky plan është një mjet për të ndihmuar në vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë, duke qenë gjithashtu një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë ndaj praktikave të paligjshme, joetike dhe korrupsionit. Plani është një dokument operativ që parashikon masa të bazuara në analizën e rrezikut, me qëllim realizimin e objektivave të integritetit të Ministrisë.

Ballafaqimi i suksesshëm me korrupsionin potencial në sistemin shëndetësor është thelbësor për arritjen e rezultateve më të larta në fushën e shëndetësisë dhe ofrimin e shërbimeve të cilësisë më të lartë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Intervenimet efektive për të adresuar këto dobësi do të kontribuojnë në përmirësimin e shëndetësisë dhe do të mundësojnë shërbime më të mira dhe më të drejta.

Ministria e Shëndetësisë, si autoriteti më i lartë në sektorin shëndetësor, ka përgjegjësinë kryesore për zhvillimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Ky proces ka ndikim të drejtpërdrejtë në luftën kundër korrupsionit potencial. Zvogëlimi i rrezikut nga korrupsioni dhe rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike janë faktorë kyç për të arritur rezultate më të mira në shëndetësi. Për më tepër, korrupsioni eventual në sektorin e shëndetësisë do të dëmtonte legjitimitetin dhe besimin publik në institucionet qeveritare. Prandaj, intervenimet e suksesshme për parandalimin e korrupsionit do të tregojnë përkushtimin e Qeverisë dhe do të rrisin transparencën dhe pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara në sistemin shëndetësor.

Plani i Integritetit pëershkruan përkushtimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të fuqizuar kontrolllet ekzistuese dhe për të përmirësuar operacionet në të gjitha aktivitetet e saj, me fokus në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuara drejt qytetarëve. Plani ofron masat për arritjen e objektivave të Ministrisë, duke theksuar forcimin e sundimit të ligjit dhe respektimin e standardeve profesionale.

Ky plan ka potencialin të ndikojë pozitivisht në agjendën për parandalimin e korrupsionit, jo vetëm në nivelin e përgjithshëm të sistemit shëndetësor, por edhe në nën-segmente specifike të tij. Plani do të paraqesë një angazhim të plotë për integritetin e Ministrisë së Shëndetësisë, duke siguruar që ajo do të mbajë qëndrim pro aktiv ndaj shkeljeve të mundshme të integritetit. Gjithashtu, do të sigurohet që suksesi i masave reformuese të mos bëhet viktimë e kërcënimeve ndaj integritetit, përmes ndikimeve abuzive të grupeve të fuqishme të interesit ose rezistencës nga brenda institucionit.

Ministria e Shëndetësisë, përmes përkushtimit të saj ndaj zbatimit të legjislacionit dhe aktiviteteve të parashikuara nga Plani i Integritetit, synon të arrijë rezultate të qëndrueshme dhe të përmirësojë vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit në sektorin e shëndetësisë.

### III. PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ, i cili paraqet një mjet thelbësor për forcimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një angazhim i drejtpërdrejtë për respektimin e vlerave morale, standardeve profesionale dhe rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, ai ofron masa të mbështetura në vlerësimin e rrezikut, me qëllim realizimin e objektivave të integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

#### Plani i integritetit mundëson:

- **Identifikimin e rreziqeve të mundshme për korruptionin** në të gjitha fushat e punës në Ministri;
- **Vlerësimin e rrezikut potencial** për shfaqjen e korruptionit, jo-profesionalizmit dhe sjelljeve jo-etike në Ministri;
- **Përcaktimin e masave për parandalimin** ose eliminimin e këtyre rreziqeve, duke përfshirë korruptionin dhe sjelljet e tjera të papranueshme.

#### Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- **Rritjen e mundësive për arritjen e objektivave të Ministrisë** duke vendosur një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të forcojë qëndrueshmërinë e Ministrisë ndaj korruptionit potencial dhe do të zvogëlojë mundësitë për shfaqjen e tij;
- **Përqendrimin në prioritetet e Ministrisë**, bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, për të mundësuar shpërndarjen efektive të burimeve të disponueshme për parandalimin e korruptionit;
- **Përmirësimin e kontolleve operative** për të rritur efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën në të gjitha proceset, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- **Mbajtjen e një sistemi të brendshëm për pajtueshmëri** me kërkесat ligjore dhe procedurale;
- **Krijimin e një mjedisi të favorshëm për parandalimin e korruptionit**, përmes trajnimeve dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar bashkëpërgjegjësinë e të gjithë stafit në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e planit;
- **Rritjen e besimit të zyrtarëve të Ministrisë dhe palëve të jashtme**, duke demonstruar përkushtimin e Ministrisë për integritet dhe transparencë.

Me zbatimin e këtij plani, Ministria do të jetë në gjendje të sigurojë një shpërndarje të efektshme, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara. Ky proces përfshin hartimin dhe monitorimin e politikave me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të sigurta për qytetarët. Gjithashtu, Ministria do të mund të sigurojë efikasitetin, efektivitetin dhe etikën gjatë arritjes së rezultateve të synuara, duke rritur kënaqësinë e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një procesi të plotë të planifikimit për integritetin dhe vlerësimit të rrezikut, i realizuar nga Ministria. Ky proces ka përfshirë identifikimin e dobësive të mundshme në Ministri, në lidhje me shkeljet e integritetit dhe vlerësimin e tyre, duke marrë parasysh ndikimet materiale dhe jo-materiale që këto shkelje mund të shkaktojnë, si dhe gjasat që ngjarje të tilla të ndodhin, duke vlerësuar aktualisht rezistencën e Ministrisë përmes rregulloreve, procedurave, kodeve dhe përfshirjes së stafit.

#### IV. Sfondi

Për të pasur një pasqyrë të qartë mbi nevojën për forcimin e integritetit institucional në Ministrinë e Shëndetësisë, është realizuar një pyetësor i shpërndarë te të gjitha institucionet administrative të përfshira në strukturën e Ministrisë. Ky pyetësor ka pasur për qëllim vlerësimin e fushave funksionale që kërkojnë ndërhyrje, me fokus në identifikimin e pikave të dobëta dhe në adresimin e çështjeve të transparencës dhe llogaridhënieve.

##### IV.1. Rezultatet e Pyetësorit

Pas mbledhjes së të dhënave, janë identifikuar disa fushat kyçë që kërkojnë ndërhyrje dhe zhvillim të masave konkrete për forcimin e integritetit institucional:

- Nevoja për forcimin e qëndrueshmërisë operative ndaj shkeljeve të integritetit:** Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve ka theksuar se ka një nevojë të menjëhershme për forcimin e mekanizmave të brendshëm për parandalimin dhe adresimin e shkeljeve të mundshme të integritetit. Ky aspekt ka lidhje të drejtpërdrejtë me zvogëlimin e rreziqeve të korruptionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare.
- Përmirësimi i administratës dhe koordinimi i burimeve njerëzore:** Shumica e të anketuarve kanë përmendur se proceset e rekrutimit, administratës së stafit dhe përfshirjes së këtij të fundit në grupe punuese janë pikë të dobëta që kërkojnë ndërhyrje. Kjo është e lidhur ngushtë me nevojën për të rritur performancën e stafit përmes motivimit dhe zhvillimit të planeve trajnuese.
- Kërkesa për trajnime dhe rritjen e njoburive për etikën dhe kodin e etikës:** Një shqetësim i evidentuar në pyetësor është mungesa e njoburive të thelluara rrëth etikës dhe kodeve të etikës nga ana e stafit. Ky aspekt ka ndikuar në përceptimin e dilemave etike dhe ka shfaqur nevojën për trajnime më të fokusuar për të adresuar këto çështje.
- Dyshimet për shkelje të mundshme të integritetit pa raportime:** Një nga gjetjet shqetësuese ka qenë se, edhe pse ka dyshime për shkelje të mundshme të integritetit, shumica e të anketuarve kanë pranuar se nuk kanë raportuar asnjë rast të tillë. Kjo është një problem që do të kërkojë forcimin e mekanizmave të raportimit dhe krijimin e një mjedisi ku të punësuarit mund të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur kur raportojnë raste të shkeljeve të mundshme të integritetit.
- Përgjegjësitë e dyfishuara dhe paqartësia në procedura:** Disa pjesëmarrës kanë theksuar se ka paqartësi në ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësive brenda Ministrisë, duke krijuar pengesa për llogaridhëni dhe transparencën. Ky është një aspekt që kërkon adresim të menjëhershëm përmes rregulloreve të brendshme dhe ndarjes më të qartë të përgjegjësive.
- Mekanizmat e brendshëm dhe njoburitë për to:** Ka një mungesë të njoburive nga ana e stafit për mekanizmat e brendshëm që mbështesin integritetin institucional, si dhe për ndërmarrjen e veprimeve për të korriguar praktikat dhe sistemet që mund të shkelin standardet etike dhe ligjore. Ky problem kërkon trajnime specifike dhe një qasje më të fokusuar për edukimin e stafit për këta mekanizma.

## V. Parimet e menaxhimit të integritetit

### 5.1. Udhëheqja

Menaxhmenti i lartë duhet të demonstrojë në mënyrë të qartë dhe të dukshme një përkushtim aktiv ndaj integritetit institucional, duke u bazuar në fakte dhe të dhëna të verifikueshme. Ky angazhim kërkon që ata të udhëheqin procesin nga fillimi, përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave të integritetit dhe kodeve të etikës. Një element thelbësor është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe të kuptohet qartë nga i gjithë stafë dhe palët e interesit.

Për të arritur këtë, është e domosdoshme që politika të implementohen në mënyrë sistematike përmes procedurave dhe praktikave të menaxhmentit, duke përfshirë aktivitete të komunikimit, konsultimit, dhe vendosjes së kontekstit të nevojshëm. Po ashtu, duhet të identifikoohen, analizohen, vlerësohen dhe monitorohen rreziqet që lidhen me integritetin, duke siguruar që të gjitha proceset të janë në përputhje me kërkuesat ligjore dhe etikën.

Ministria e Shëndetësisë është vetëdijshme për rolin e saj si mekanizmi kryesor në sektorin e shëndetësisë, duke pasur potencial të madh për të ndikuar në ndryshime pozitive përmes nxitjes dhe implementimit të Planit të Integritetit. Ky plan mund të shërbejë si model për të tjerët, duke përfshirë sektorët e tjera publikë dhe institucionale shëndetësore si Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), për të ndërmarrë veprime të nevojshme për forcimin e rregullave dhe praktikave që parandalojnë korruptionin dhe promovojnë rezultate të përmirësuara në shëndetësi.

### 5.2. Përfshirja e Personelit

Pjesëmarrja aktive dhe angazhimi i gjithë stafit janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të sistemit të menaxhimit të integritetit. Megjithatë, përfshirja e plotë kërkon edukimin dhe trajnimin e duhur për çështjet që lidhen me integritetin, si dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e tij. Kjo do të krijojë një besim dhe një mjeshtëri pozitiv pune, ku të gjithë individët do të ndihen të angazhuar dhe të mbështetur.

Komunikimi dhe koordinimi i brendshëm dhe i jashtëm janë të rëndësishëm për një punë të suksesshme ekipore, që do të sigurojë që të gjitha palët e përfshira të kenë një kuptim të njëjtë dhe të saktë të projektit dhe procesit gjatë implementimit të tij.

Plani i Integritetit nuk është një dokument statik; ai është një mjet dinamik që do të monitorohet dhe do të përditësohet rregullisht për të pasur përshtatshmëri me ndryshimet ligjore, zhvillimet relevante institucionale dhe ndryshimet në nivelin e stafit, brenda dhe jashtë institucioneve. Ky proces do të ndihmojë që plani të mbetet efektiv dhe i përshtatshëm për çdo situatë të re që mund të shfaqet.

### 5.3. Qasja Sistemore

Për të identifikuar fushat e mundshme të korruptionit dhe menaxhuar proceset që lidhen me integritetin, është e nevojshme një qasje sistemore. Kjo do të thotë se Ministria e Shëndetësisë do të duhet të analizojë çdo njësinë brenda saj dhe të kuptojë ndërvarësinë dhe lidhjet që ekzistojnë mes tyre. Plani do të fokusohet në zhvillimin e një qasjeje sistematike që do të përfshijë mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e rezultateve të zbatimit të masave për integritetin.

Një komponent i rëndësishëm i kësaj qasjeje do të jetë komunikimi i qartë dhe i rregullt i rezultateve të masave të implementuara, përmes raporteve periodike të integritetit, që mund të janë pjesë e raporteve tremujore brenda institacioneve, si dhe raporteve të rregulla që dërgohen në Autoritetin për

## **MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

Përcjelljen e Korrupsionit (APK). Ky proces do të sigurojë transparencë dhe do të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe praktikave për të adresuar rreziqet e integritetit në institucionet shëndetësore.

## VI. Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe vendos përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korruptionit dhe të sjelljeve jo etike në Ministri të Shëndetësisë.

**6.1. Objektiva strategjike I:** Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit përmes zbatimit të kornizës strategjike relevante mbi integritetin.

Investimet që bëhen në sektorin e shëndetësisë mund të mos kenë rolin dhe ndikimin e dëshiruar nëse në investimet shëndetësore nuk ndërtohen mekanizmat e brendshme për të adresuar rreziqet korruptive. Masat parandaluese pro-aktive mund ti mbrojnë investimet e bëra. Praktikat e intervenimeve nga Ministria e Shëndetësisë bëhen pas marrjes së rekondimeve nga mekanizmat e kontrollit të jashtëm dhe të brendshëm siç është rasti me rekondimet e auditorit. Mbikëqyrja dhe raportimi i rregullt në Ministrinë e Shëndetësisë për mospërputhjet në procedura dhe standarde operative dhe mungesat në zbatim të tyre janë mekanizma kyç për të adresuar problemet potenciale korruptive. Për këto qëllime, janë paraparë aktivitetet në planin e veprimit.

### 6.2. Objektivat specifike janë:

- I. Rritja e transparencës, përgjegjshmërisë në zbatim ndaj ligjeve dhe rregulloreve, si dhe respektit ndaj personave tjera;
- II. Rritja e vëtdijesimit të zyrtarëve të MSh-së mbi rreziqet e korruptionit dhe raportimit të tyre;
- III. Avancimi dhe mbështetja e mekanizmave për raportim të rasteve të korruptionit;
- IV. Rritjen e besimit të zyrtarëve të organizatës dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Ministria e Shëndetësisë;
- V. Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve administrative.

Reforma në shëndetësi bazohet në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e ofruesve të kujdesit shëndetësor përmes themelimit të strukturave reja dhe funksionalizimit të strukturave aktuale.

### Reforma si tërsi përfshinë:

- Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit;
- Ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta;
- Krijimi i skemës së sigurimeve shëndetësore për të siguruar qasjen në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët;
- Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë

Të gjitha këto zhvillime ofrojnë një bazë të fortë për avancimin e agjendës së menaxhimit të integritetit në institucionin shëndetësor. Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë (MSh) angazhohet për fuqizimin e reformës institucionale, me qëllim përmirësimin e integritetit dhe parandalimin e korruptionit. Ky proces do të fokusohet në disa fusha kyçë:

**Forcimi i Rezistencës së Organizatës ndaj Shkeljeve të Integritetit:** MSh do të përmirësojë dhe forcë kornizën ligjore dhe politikat për integritetin, duke integruar këto praktika në të gjitha funksionet dhe procese e saj. Ky angazhim do të realizohet përmes forcimit të kontrollit të integritetit operativ dhe mbikëqyrjes në fushat kyçë që janë më të ndjeshme ndaj rreziqeve të korruptionit. Rezistenca e

shtuar ndaj shkeljeve të integritetit do të arrihet përmes forcimit të burimeve të brendshme njerëzore dhe krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm për menaxhimin e rrezikut të integritetit.

**Integrimi i Menaxhimit të Rrezikut të Integritetit:** Menaxhimi i rrezikut të integritetit do të bëhet pjesë përbërëse e përgjegjësive të menaxhimit dhe udhëheqjes, duke e integruar atë si element thelbësor të kulturës institucionale. Ky proces do të sigurojë që organizata të zhvillojë një qasje proaktive në identifikimin dhe adresimin e rreziqeve të mundshme që lidhen me korruptionin, duke forcuar gjithashtu kontrollin e integritetit në procese dhe nën-fusha kyçë të shëndetësisë.

**Mbështetje dhe Promovim i Kulturës së Integritetit në Sektorin e Shëndetësisë:** Një fokus tjetër do të jetë mbështetja dhe promovimi i kulturës së integritetit në të gjithë sektorin e shëndetësisë në Kosovë. MSh do të angazhohet në implementimin e praktikave të mira dhe do të vlerësojë ndikimin e institucioneve që promovojnë integritetin, duke siguruar që ato të përmirësojnë vazhdimeshit politikat dhe praktikat e tyre, si dhe të përshtaten me nevojat e reja dhe sfidat e vazdueshme.

**Roli i Ministrisë së Shëndetësisë në Zbatimin e Planit dhe Ndikimi në Institucionet Shëndetësore të Tjera:** Roli i Ministrisë së Shëndetësisë si autoritet kryesor në zbatimin e këtij plani do të jetë vendimtar. Përveç masave që do të ndërmerren brenda MSh për të përmirësuar rezistencën ndaj shkeljeve të integritetit, plani parashev edhe masa të cilat do të ndikojnë në institucionet e tjera shëndetësore publike dhe Fondin e Sigurimit Shëndetësor. Kjo do të mundësojë një koordinim më të mirë dhe forcim të kapaciteteve të përgjithshme për parandalimin e korruptionit dhe promovimin e integritetit në të gjithë sektorin shëndetësor.

## VII. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument i hartuar mbi bazën e një vlerësimi të detajuar të integritetit të punës dhe institucionit, i cili përfshin analizën e pajtueshmërisë, raportet e PI dhe mënyrës së veprimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe punonjësve të saj. Ky plan është rezultat i një vetëvlerësimi të thelluar të ekspozimit ndaj rreziqeve, që mund të çojnë në shkelje të integritetit, korruption dhe sjellje të papranueshme etike dhe profesionale. Nëpërmjet këtij plani, Ministria synon të zhvillojë një kuadër të fortë për parandalimin e këtyre fenomeneve dhe të sigurojë që praktikat e punës dhe proceset institucionale të jenë të përputhshme me standartet e integritetit dhe etikës profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Ministrisë së Shëndetësisë; dhe
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zgjedhur rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitet organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit është bërë vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të administratës në Ministrinë e Shëndetësisë. I gjithë stafi i Ministrisë ka marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të ministrisë dhe ka propozuar masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve. Ky proces është realizuar për herë të parë në Ministrinë e Shëndetësisë në vitin 2022 ku është aprovuar lista e rreziqeve. Po ashtu Ministria në kuadër të planifikimit vjetor të aktiviteteve për secilin departament dhe njësia ka paraparë edhe rreziqet.

### 7.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit në ministri është realizuar në disa fazë, si në vijim:

- **Faza përgatitore** – Sekretari i përgjithshëm ka themeluar grupin e punues ku është përcaktuar struktura e grupit punues dhe kryesuesi i tij. Grupi punues ka mbledhur informacione të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe ka njoftuar të gjithë stafin për rendësinë e Planit të Integritetit. Ministria e Shëndetësisë meqenëse dhe me herët ka pasur plan të integritetit institucional, këtë proces e ka hartuar dhe dizajnuar me lehtë, por edhe duke marrë mbështetjen me asistencë teknike nga USAID.
- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze kryesuesi së bashku me grupin punues kanë analizuar dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Ministrisë, përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie të Ministrisë), si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale janë përcaktuar fushat e rrezikut dhe është bërë identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve.
- **Faza e përcaktimit të prioriteteve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – Ministria e shëndetësisë përmes grupit punues i cili është takuar në bazë të vlerësimit të Kryesuesit së paku njëherë në javë, ka përcaktuar prioritetet për intervenimin, përcaktimin e masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe zyrtarët përgjegjës për zbatim. Pas hartimit të draftit fillestar Plani i Integritetit i është përcjellë për konsultim final të gjitha njësive/departamenteve të MSh për të marr komentet e fundit dhe finalizimin e planit.

- *Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit* - Ministria e Shëndetësisë si pjesë e vazhdimësisë së monitorimit të zbatimit të Planit të integriteti institucional ka caktuar zyrtarin përgjegjës brenda administratës, që është përgjegjës për monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktivitetave që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, sipas Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm raportimi i procesit është i rregullt, që rrjedhimisht mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve, që rezulton në zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

## **7.2. Metodologja e vlerësimit të rrezikut**

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e Jashtëm që janë identifikuar dhe aprovuar.

Kjo ka qenë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, priorititetet janë përcaktuara ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, janë vendosur aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, janë në përputhje-me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit.

Në anën tjeter, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate, për të cilat Ministria është vetëdijshme dhe do ti kushtoj rendësi të veçantë.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimi) të rrezikut të ndodhur, grapi punues ka përcaktuar nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identikuara dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut është përcaktuar bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

## **7.3. Matrica vlerësimit të rrezikut**

Matrica e vlerësimit të rrezikut ka mundësuar të llogaritet rreziku në fushat apo aktivitetet e Ministrisë për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo ka bërë më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e njësisë brenda Ministrisë në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
Mesatar	Mesatar	7									
		6									
		5									
Vogël	Vogël	4									
		3									
		2									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi )	Ulët	Mesatar	Lartë
<b>Probabiliteti/Gjasat</b>			

Intensiteti i rrezikut është fituar duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

#### 7.4. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korruptionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, është vlerësuar nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 - 15 pikë	16 - 48	49 - 100

- █ Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korruptionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- █ Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korruptionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- █ Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## VIII. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizmat përkatës tashmë të themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe do të rishikohet periodikisht, si dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të administratës dhe njësive përbërëse të Ministrisë së Shëndetësisë. Raportimi do të bëhet sipas përcaktimit ligjor bazuar në Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, rrjedhimisht raportet do të publikohen sipas përgjegjësive ligjore.

Po ashtu me qëllim të monitorimit më efikas, raportimi brenda institucionit, nëse është e nevojshme do të jetë në fazë tremujore i cili do të përcillet te mekanizmi i brendshëm monitorues për monitorimin e zbatimit të politikave institucionale.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi do të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut të integritetit kanë prodhuar efektet e planikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit, rapporti do të dërgohet për diskutim në mekanizmat më të lartë administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë.

Pra, me qëllim të sigurimit të zbatimit të Planit të integritetit, janë themeluar mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. **Grupi punues** - është emëruar me vendim të sekretarit të përgjithshëm dhe është përgjegjës për të evidentuar:

- promovimin e integritetit në Ministri të Shëndetësisë dhe merr masa për të parandaluar korrrupsionin potencial, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;
- hartimin e draftit të Planit të Integritetit institucional;
- përgatitjen e programit për hartimin e planit të integritetit;
- siguron që Plani i integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
- zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
- propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit të integritetit institucional të Ministrisë së Shëndetësisë. Sekretari i Përgjithshëm themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. **Koordinatori për mbikëqyrje të integritetit** – është emëruar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe është përgjegjës për:

- përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;

- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhur dhe analizuar dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Ministrisë, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korruptionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- përgatitë dhe shpërndan pyetësorin si dhe zhvillon intervistat me stafin e administratës së ministrisë, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;
- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të integritetit si dhe standarde, format dhe procedurat për të mbështetur Planin e integritetit;
- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton ZKA.

Koordinatori, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatori i rekomandon Sekretarit të Përgjithshëm për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

**IX. Fushat e rrezikut**

**9.1. Fushat e përgjithshme të rrezikut**

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- I. Planifikimi dhe menaxhimi ;
- II. Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- III. Komunikimi dhe informimi;
- IV. Ruajtja dhe siguria e të dhënave.

**9.2. Fushat specifike të rrezikut**

Fushat e specifike të rrezikut janë:

- I. Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave.
- II. Furnizimi me barna
- III. Inspektimet

MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)

Matrica e Planit i Integritetit Ministratë e Shëndetësisë						
Identifikimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut		Fushat e përgjithshme të rrezikut		
Përshtkimi i Rrezikut	Përshtkimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zwogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zërtari përgjegjës	Afat i realizimit
Fusha e rrezikut	Fusha e rrezikut	Gjasat	Ndikimi	ZKA	ZKA	ZKA
Planifikimi dhe menaxhimi	Mos hartimi i legjisacionit	Monitorimi i zbatimit të programit dhe planit legislativ	4      8      32	Shfrytëzimi i drafteve të viteve të kaluara; Shfrytëzimi i memories institucionale.	Zyrtari përgjegjës pë r hartimin e politikës	Mars 2025
Mos miratimi i politikave	Raportet për zbatim të planeve strategjike	Planifikimi bazuar në dokumente ndër sektoriale	8      8      64	Hartimi i planeve strategjike mbi bazën e SSSh 2030	Zyrtari përgjegjës pë r hartimin e politikës	Mars 2025

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

Mungesa e standardeve për ofirimin e shërbimeve shëndetësore	Zbatimi i standardeve të OBSH	8	8	64	Zbatimi i planit për hartimin e UPK	Udhëheqësi i DZhSSh	Autorizuesi i programit	Janar - Dhjetor 2025
Mos zbatimi i projekteve kapitale	Zbatimi i kornizës ligjore dhe operacionale	8	8	64	Vlerësimi i nevojës për investim Përcaktimi i kritereve për projekte kapitale	Hartimi i detajuar i Planifikimit Final te Prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit;	
Mos zbatimi i planit të prokurimit	Plani i prokurimit	4	8	32	Hartimi i kërkesave me specififikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikimi i duhur i çmimeve;	Hartimi i kërkesave me specififikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikimi i duhur i çmimeve;	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit; Zyrtarët autorizues	Janar- Dhjetor 2025
Raportet për zbatim të planit					Monitorimi i zbatimit të planit të prokurimit.	Zyrtarët autorizues	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit;	
Mos planifikimi dhe ekzekutimi adekuat i buxhetit	Intervenimet dhe përmirësimet	5	8	40	Përcjellja muiore e pagesave ne kapitale;	Zyrtari përgjegjës (D. Financave)	Janar- Dhjetor 2025	
					Raporim i Ekzekutimit të penalitive	Udhëheqësi i Div. prokurimit/Menaxheri i kontratës	Janar- Dhjetor 2025	

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

	Planifikimi i Buxhetit në detale	Udhëheqësi i Divizionit të Financave	Mars - Qershor 2025
	Barazimi ditorë i zyrtarit për barazime dhe njoftimi i me njëherësh i mbikëqyrësít në MFPT në rast të mos barazimit.	Zyrtari përgjegjës i Departamentit të Financave	Janar - Dhjetor 2025
Ndikimi në procesin e rekrutimit të stafit	Zbatimi i kormizës ligjore dhe institucionale	Zbatimi i parimit të meritës.	Divizioni i personelit Janar - Dhjetor 2025
Mos njojja me regullat/praktikat në fushat kryesore të mbrojtjes së integritetit	Intervenimet dhe përmirësimet	Zhvillimi i stafit përmes trajnimeve adekuate, njoftimit zyrtar, publikimit në ueb faqe dhe fushatave vëtëdijësuese	Divizioni i personelit Janar - Dhjetor 2025
<b>Politika e burimeve, njërezo, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve</b>		Zbatimi i PSO për deklarim të konfliktit të interesit	Zyrtari përgjegjës për regjistrimin e rasteve të deklaruara Janar - Dhjetor 2025
Mos deklarimi i konfliktit të interesit	PSO e hartuar	Zbatimi i planit të komunikimit	Divizioni i komunikimit Janar - Dhjetor 2025
Moszbatimi Efektiv i Planit të Komunikimit	Komunikimi bazuar në nevoja		

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

<b>Komunikimi dhe informimi</b>	Moszbatimi i PSO-së për Ngritjen e Përgjegjësisë dhe Transparencës	Mbështetja në ekspertizën e Divisionit për informim	5 8	40	Zbatimi i PSO për ngritjen e përgjegjësisë, transparencës përmes komunikimit brenda ministrisë	Zyrtari përgjegjës DKP	Janar-Dhjetor 2025
Mos publikimi i rezultateve të zbatimit të masave të integritetit	Hartimi i raportit për zbatimin e planit të integritetit institucional	5 8	40	Publikimi i raportit për zbatimin e planit të integritetit	Koordinatori I Planit të Integritetit	Janar - Korrik 2025	
Mungesa e pasqyrës së saktë të morbiditetit dhe mortalitetit	Vendim marja bazuar në raporte zyrtare	7 8	56	Monitorimi dhe ngritisja e kapaciteteve për raportim	IKSHPK		
Mos shfrytëzimi i modulit për burime njerëzore	Shfrytëzimi i SISh bazik	7 8	56	Popullimi me të dhëna i moduleve ekzistuese	DSISh		
<b>Ruajtja dhe siguria e të dhënavës dhe dokumenteve</b>	Mos lidhëshmëria e moduleve elektronike të SISh në kuadër të DShB	8 10	80	Ndërlidhja e sistemit të RSh, SMSF dhe BHIS në atë mënyrë që hyrja në institucion të hap	DShSh/ Kordinatori i DShB		

**MINISTRIA E SHËNDETËSISÉ - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

në dobi të produktit			qasjen në sítmini e SMSF dhe BHIS	
	Shfrytëzimi i burimeve tjera për burime njerëzore	Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit SMSF		DSISh
Mos shfrytëzimi i SMSF	Popullimi i moduleve ekzistuese të vaksinikut me të dhëna SMSF/BHIS	Identifikimi dhe raportimi i sfidave përmos popullimin e moduleve të vaksinimit me të dhëna		IKShPK
	Shfrytëzimi i raporteve zyrtare	Zbatimi i Planit strategjik për zhvillimin e SISh	Zyrtari përgjegjës për monitorimin e Planit	Janar - Dhjetor 2025
	Shfrytëzimi i SISh bazik	Zbatimi i planit të strategjik të SISh sipas rekomandimeve të SF.	DSISh	

MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLAN I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)

Regjistrim i rrezikut		Fushat e vëçanta të rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Pershkrimi Rrezikut	Vlerësimi dhe matja e rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqueve	Njësia/zyrari përgjegjës	Afati		
Fusha e rrezikut	<b>Vlerësimi i rrezikut</b> <b>Ndikimi</b> <b>Gjasat</b>						
Mos planifikimi i duhur	Intervenimet dhe plotësimet në planin e prokurimit	5	8	40	Rishikimi i Planifikimit të Prokurimit	Udhëheqësi I Divizionit të prokurimit	Qershor 2025
Neglizhenca përinicim te aktiviteve	Njofimi përvonesa në iniciimin e aktiviteve ne përputhje me planin e prokurimit	6	8	48	Paralajmërimi për iniciimin e aktiviteve ne përputhje me planin e prokurimit	Udhëheqësi I Divizionit të Prokurimit	
Hartimi jo i duhur i kërkesave për tenderim		6	8	48	Hartimi i kërkesave për tenderim me specifikan e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikim të duhur të çmimeve.		
Mos përputhje me çmimet e parashikuara dhe tregut	Adaptimi dhe përmirësimi i kërkesave	6	8	48		Njësia kërkuese	
<b>Prokurimi publik dhe menaxhimi i</b>							

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

projekteve/kontrat ave	Hartimi i raporteve	Publikimi i raporteve dokumenteve dhe kontratave të prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit
Dëmtimi i imazhit te institucionit për nivelin e ultë të zbatimit të projekteve kapitale	PSO (Procedura Standarde Operative) Nr. 05- 4366 për Inicimin e aktiviteteve te prokurimit për kontratat për punë ndërtimore	Zbatimi i udhëzimeve UA 04/2009 dhe UA 06/2009 -Definimi i projekteve kapitale, UA 06/2009- Kriteret e përzgjedhjes dhe prioritizimi i projekteve kapitale si dhe Procedurës Standardë Operative Nr. 05-4366	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit
Mos komunikimi i duhur mes anëtarëve të komisionit vlerësues dhe Div. te Prokurimit	Mos komunikimi i duhur mes anëtarëve të komisionit vlerësues dhe Div. te Prokurimit	Përmirësimi i komunikimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit
Ndërprerja e kontratës	LPP dhe Rregullorja për prokurim publik	8 8	64 kontratave
Mos vlerësimi ne kohe ne përputhje me dispozitat e LPP-se	LPP dhe Rregullorja për prokurim publik	6 8	48 Trajnim i menaxherëve të vlerësimin e tenderëve
			DBNj
			DBNj

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

<b>Furnizimi me barna</b>	Mos planifikimi i mirëfilltë nga institucionet shëndetësore të KPSH	Intervenimit për pëmiresim të kërkuesave që tejkalojnë nevojat reale	8	8	64	Planifikimi i barnave në SMSF	Udhëheqësi I Divizionit të Farmacisë
	Mungesa e barnave në institucionet shëndetësore	Sigurimi i barnave bazuar në nevoja	5	8	40	Planifikimi obligator i të gjitha produktive në listën esenciale	
	Jo stabilitet i tregut për produkte farmaceutik të listës esenciale	Krijimi i mundësisë për negocim me produues farmaceutik	8	8	64	Lidhja e kontratave kornizë	Udhëheqësi I Divizionit të Farmacisë
	Mos përbushja e detyrimeve ligjore nga ana e operatorëve ekonomik	Marja e masave administrative	8	8	64	Lëshimi i referencave negative për operatoret ekonomik të papërgjegjshëm	Udhëheqësi I Divizionit të Farmacisë
	Mos respektimi i listës specifike të barërave për burgje	Krijimi i mundësisë për negocim të drejtpërdrejtë me produues farmaceutik	8	8	64	Zhvillimi i fushatave informuese publikun për rëndësinë e furnizimit me barna	Janar-Dhjetor 2025
						Zbatimi i listës së barërave specifike dhe shëmangja e pengesave administrative dhe të prokurimit	Divizioni i prokurimit / DShB

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË - PLANI I INTEGRITETIT INSTITUCIONAL (2025 – 2027)**

Procedurat ankimore të tej zgjatura në OShP	Shffytyezimi i hapësirave ligjore për bletje emergjente	8	8	64	Komunikimi i rregullt me OSHP në lidhje me rëndësinë e furnizimit me barna	Udhëheqësi I Divisionit të Farmacisë
Humbje reputacionit	Njoftimi i opinionit publik për furnizim me barna	6	8	48	Komunikimi i rregullt me publikun në rast se tenderët përfundojnë me barna përfundojnë në procedura të ankesave	Divizioni i Komunikimit me Publikun Janar-dhjetor 2024
Inspektimi	Mungesa e mbikëqyrjes dhe monitorimi i subjekteve/institucioneve dhe profesionistëve shëndetësor që ofrojnë shërbime shëndetësor	6	8	48	Inspektimi të planifikuar dhe sipas rastit Inspektorati Shëndetësor / Inspektorati Faramaceutik	Inspektori / Shëndetësor / Inspektorati Faramaceutik Tetor 2025
Vonesat në ekzekutum të kundërvajtjeve inspektuese	Paqartësi të roleve dhe përgjegjësive	6	8	48	Miratimi I Plotësim/Indryshimit të Ligjtë Inspektoratit Qendoror Shëndetësor Krijimi i modulit elektronik për inspektimi	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës Qershori 2025 SISH Tetor 2025